

MERR KONTROLLIN NË NJË NGARKUES CAT® BACKHOE

GUIDA JUAJ PËR KONTROLLET E SEDILJES



Teknoxgroup



REHATI DHE KONTROLL I PLOTË

KONTROLLET ELEKTRO-HYDRAULIKE CAT® TË MONTUARA NË SEDILJE JANË TË THJESHTA, TË SIGURTA DHE TË REHATSHME PËR TU PËRDORUR.

Zgjidhni pozicionin e operimit dhe përcaktojni vetë shpejtësitë. Kontrolli është në duart e juaja.

Këto kontrolle ofrojnë:

- ✓ siguri dhe besueshmëri
- ✓ hidraulike dhe kohë përgjigjeje të rregullueshme
- ✓ rehati e përmirësuar - kontrollet lëvizin me ju
- ✓ më pak tuba dhe më pak nxehtësi në kabinë
- ✓ më shumë hapësirë për këmbët dhe sendet në kabinë
- ✓ dizajn ergonomik dhe i axhustueshëm
- ✓ pjesë të durueshme.

Zgjidhni një ngarkues Cat backhoe 432 ose 444 për të përfutur nga këto kontrolle. Siç na thonë operatorët, pasi t'i provoni, është vështirë të kthehesh pas!

KONFIGURIMI I RI I LEVËS? OPERATORËT "MENDOJNË QË ËSHTË FANTASTIK!"

BOB COTNER, PRONAR I SOLID ROCK EXCAVATION, SH.B.A.

"AVANTAZHI MË I MADH I LEVËS SË INTEGRUAR. MUND TË PUNOSH ME SEDILJEN PJESËRISHT TË KTHYER. KA SHIKUESHMËRI SHUMË TË MIRË PËR ATASHIMET E BACKHOE."

JAKUB PRZYBYŁA, PUNON TEK PRZEDSIĘBIORSTWO ROBÓT DROGOWYCH, POLONI



GUIDA E OPERIMIT

**KONTROLLET E MONTUARA NË SEDILJE
PËRMIRËSOJNË REHATINË,
PERFORMANCËN DHE SHIKUESHMËRINË.
MUND TË OPEROSH NGARKUESIN,
KRAHUN OSE TË DYJA - NË ÇDO POZICION**

SEDILJA ME DREJTIM NGA NGARKUESI

Kurseni kohë dhe përmirësoni rehatinë gjatë rrugës

Mund të operosh tërësisht ngarkuesin duke përdorur levën në krahun e djathtë. Leva e krahut të majtë është e çaktivizuar. Gjithsesi, duke shtypur butonin Dual Mode dhe duke e shtypur këmbëzën në levën e krahut të majtë, ju keni kontroll të plotë mbi ekstimator. Kjo është e dobishme për axhustime të vogla në lëvizje.

SEDILJA ME DREJTIM NGA EKSNAVATORI

Kurseni kohë dhe bëjeni ripozicionimin e makinerisë më të rehatshëm

Ju mund të operoni ekskavatorin kur jeni me drejtim nga ana e pasme e makinerisë. Mbani shtypur këmbëzën në levën e anës së majtë për të aktivizuar Dual Mode. Kjo do të thotë që mund të kontrolloni ngarkuesin me dorën e djathtë, dhe krahun me dorën e majtë.

ZGJIDHNI POZICIONIN SHIJONI 180 GRADË OPERIM

Poziciononi sediljen tuaj midis ngarkuesit dhe ekskavatorit për rehati dhe shikueshmëri kur pastroni gropa, gërmoni kanale ose ngarkoni kamiona. Mund të zgjidhni të keni kontroll të plotë të ekskavatorit ose të aktivizoni Dual Mode duke mbajtur këmbëzën e levës së krahut të majtë shtypur.

E RE: DUAL MODE LEHTËSI ME NJË PREKJE TË BUTONIT

Përfitoni nga kontroll më i mirë dhe shikueshmëri me Dual Mode. Tani mund të kontrolloni tërësisht implementimet në krahun e kundërt në të cilin jeni të drejtuar, ose të operoni krahun dhe ngarkuesin në të njëjtën kohë kur ripoziciononi makinerinë. Gjithashtu mund të aktivizoni Dual Mode kur jeni ulur në kënd për shikueshmëri më të mirë.

NJË MAKINERI E QËNDISUR PËR TY

Është e lehtë të axhustoni përgjigjet e makinersë që t'u përshtaten ju. Thjesht përdorni ekranin për të përcaktuar parametrat tuaja:

PUNONI ME HAPIN TUAJ

Mund zgjidhni sa shpejt hidrauliket përgjigjen sipas dëshirës, aftësisë tuaj ose punës që keni në dorë.

Modulimi i krahut kontrollon shpejtësinë e hidraulikeve. Shkalla e përgjigjshmërisë ndryshon se sa shpejt hidrauliket i përgjigjen komandave të levës.

Mund ti axhustoni të dyja duke përdorur ekranin e ri dhe interaktiv.

REHATIA DHE SIGURIA JUAJ JANË PRIORITETI YNË

Çdo aspekt i kabinës është dizenuar për rehatinë dhe sigurinë tuaj. Suspencioni i ajrit axhustohen sipas peshës dhe mund të ndryshoni pozicionin e mbështetëses së krahut. Mund të vendosni kur të ndizni kontrollet elektro-hidraulike.

Në kabinën tuaj Cat, ju jeni gjithmonë në kontroll.



Për të zbuluar më shumë rreth gamës së re të ngarkuesve backhoe, kontaktoni shitësin tuaj lokal Cat ose vizitoni www.teknoxgroup.com.



© 2020 Caterpillar. Të gjitha të drejtat e rezervuara. CAT, CATERPILLAR, LET'S DO THE WORK, dhe logot përkatëse, "Caterpillar Yellow", "Power Edge" dhe "Modern Hex" si edhe identiteti i produktit dhe korporativ i përdorur këtu, janë marka të regjistruara të Caterpillar dhe nuk mund të përdoren pa leje.